



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:187496
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05743891

AA.nr.508/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I.M., nga P., rruga “...”nr....., kundër të paditurës Policia e Kosovës- Drejtoria e Përgjithshme, Komisioni për Ankesa, me bazë juridike anulimi i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2272/20, të datës 14.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, merr këtë;

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit I.M., e datës 05.07.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2272/20, i datës 14.04.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin e ankimuar, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit I.M. nga P., rruga “...”nr....., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi, nr. ... datës ..., duke anuluar gjobën prej 201.00 euro dhe shfuqizuar pikën negative dhe rimbursim prej 40 euro për shërbim-përkthim, apo i njëjti të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të priset aktgjykimi i ankimuar dhe çështja të kthehet në rigjykim. Duke i propozuar gjykatës që me ekspertizë të komunikacionit ku detyrë ekspertëve duhet të jetë vlerësimi i kontributit të pjesëmarrësve në aksidentin lëndor.

Gjykata e Apelit, shqyrtoi pretendimet ankimore, aktgjykimin e ankimuar si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) dhe neni 194 të LPK-së, i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjen se;

Ankesa është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr.... i datës ..., ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e parashtruar nga ankuesi I.M., dhe ka mbet në fuqi vendimi i nivelit lokal Drejtorisë Rajonale të Policisë në Prishtinë, me nr. MDNL-PR-..., i datës ..., me të cilin vendim zyrtari policor M. B. PK.... me detyrë në NJRKRR, DRP-Prishtinë është shpall i pa fajshëm.

I pakënaqur me vendimin e lartcekur, paditësi me padi inicion konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të paditurës. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative në këtë çështje pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit publik të datës 13.04.2023, në prani të paditësit, e në mungesë palës të paditur (i ftuar në mënyrë të rregullt), dhe pas administrimit të provave merr aktgjykimin, e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, sipas konkludimeve në arsyetim se; duke u bazuar në shkresat e lëndës që lidhen me padinë e paditësit sa i përket anulimit të vendimit të paditurës vlerëson se e paditura drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike kur ka refuzuar ankesën e paditësit si të pa bazuar, për faktin se nuk është vërtetuar ndonjë gjendje tjetër faktike nga ajo e cila është vërtetuar me vendimin e organit të shkallës së parë dhe se në veprimet e zyrtarit policor ka ushtruar ankesë paditësi nuk kanë gjetur elemente për shkelej disiplinore.

Paditësi me asnjë provë nuk dëshmon pretendimet e veta, të cilat do ta dëshmonin një gjendje tjetër nga ajo që është vendosur me vendim nga e paditura, ndërsa faktet e prezantuara të bashkangjitura padisë e që gjykata edhe i ka administruar si prova siç janë Fletëparaqitja për kundërvajtje dt.... me nr. SHQ5A... i lëshuar nga Policia e Kosovës, Vendimi i Komisionit për Vendosje Nr.i lëndës KV.Nr...., i datës ... janë prova që trajtohet dhe shqyrtohen nga organi administrativ tjetër që merret me shqyrtimin e çështjeve konkrete e që padi duhet të drejton ndaj organit tjetër administrativ në kuptimin subjektiv, andaj në rastin konkret sipas padisë së parashtruar nga paditësi ku ka kërkuar anulimin e vendimin këto prova nuk janë relevante e që janë pa ndikim në vendosje.

Andaj në këto rrethana tani të argumentuara, gjykata përfundimisht vlerëson se vendimi i të paditurës është vendim i drejtë, i bazuar në dispozitat ligjore dhe me vërtetim të drejtë të gjendjes faktike, pasi që faktet e konstatuara janë në përputhje të plotë me provat që gjenden në shkresat e lëndës, siç janë Hetimi i rastit me nr. ... dt...; Vendimi dt. ... Drejtoria Rajonale e Policisë Prishtine Stacioni Policor NJRKRR nr.MDNL –PR-... dt. ..., e i cili vendim është marr pas vlerësimit të ankesës së palës paditëse dhe vlerësimin të gjendjes faktike dhe zhvillimit të hetimeve sipas ankesës së palës paditëse, andaj edhe gjykata ka konstatuar gjendje faktike të njëjtë me atë të konstatuar nga ana e të paditurës në vendimet e saj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të ankesës së paditësit dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë të bazuar në prova dhe ligj, sepse i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe neni 194 të LPK-së, dhe as me shkeljet sipas pretendimeve në ankesë.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të Policisë të Kosovës si në vështrim të nenit 9, dhe 44 të LKA, në seancën e shqyrtimit kryesor, si në vështrim të nenit 38.1.2 të LKA, pas administrimit të provave, e edhe në bazë të fakteve të

vërtetuara në procedurë administrative, nga komisioni për ankesa i Policisë së Kosovës, vendos drejtë me lënien në fuqi të vendimit të organit të shkallës së parë, si vendim i drejtë dhe ligjor i nxjerrë në bazë të dispozitave ligjore të LPPA-së, dhe ligjit material, ku pa dyshim është vërtetuar se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, sepse nga Hetimi i rastit me nr. ... dt....; Vendimi dt. ... Drejtoria Rajonale e Policisë Prishtine Stacioni Policor NJRKRR nr.MDNL –PR-... dt. ..., nga këto prova të shqyrtuara edhe në procedurë gjyqësore pala paditëse nuk ka mundur të siguroj dëshmi që qojnë në një gjendje tjetër faktike nga ajo që është konstatuar në gjykatën e shkallës së parë dhe në organin e paditur.

Nga këto fakte vërtetohet se nuk janë bërë shkelje ligjore nga ana e organit të paditur i njëjti ka vendosur në mënyrë të drejtë, ngase paditësi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme për një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vendosur në organin e paditur.

Pretendimet ankimore të paditësit të theksuara si më lartë, se janë bërë shkelje të dispozitave të procedurës dhe konstatim i gabuar i gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i shqyrtoi në mënyrë të plotë në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse nuk dëshmohet me asnjë provë relevante se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve ankimore, ndërsa në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike e çështjes nga gjykata e shkallës së parë ku është vërtetuar se paditësi nuk disponon me prova se e paditura si në vendimin e saj.

Kolegji duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat materiale dhe procedurale me rastin e refuzimit të kërkesë padisë së paditësit dhe vërtetimit të vendimit të organit administrativ përfundimtar në procedurë administrative dhe pasi që me thëniet në ankesë aktgjykimi i shkallës së parë nuk vihet në dyshim, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartë cekurat e si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 i Ligjit për procedurën kontestimore u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.508/2023, datë 21.05.2024

Kryetare e kolegjit,
Delushe Halimi